**DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR**

---

**L E J E**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_

**PËR**

**USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES SË**  
**PJESËVE MEKANIKE DHE TË MOTORIT, TË KARROCERISË, TË IMPIANTIT**  
**ELEKTRIK DHE TË GOMAVE, TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE**  
**RIMORKIOVE**

**( SEKSIONI A, B, C, Ç )**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor \_\_\_\_\_ lëshon këtë leje.

**I LËSHOHET:**

- Subjektit juridik: \_\_\_\_\_

- Administrator: \_\_\_\_\_

- Me seli në:

Leja është e vlefshme deri në datën \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_.

---

**(Emri, mbiemri)**  
**D R E J T O R**

**MODELI I REGJISTRIT PËR MBLEDHJEN, DEPOZITIMIN, PJESËTIMIN DHE COPËTIMIN E MJETEVE**

Nr.	Data e hyrjes	Gjenealitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Te dhëna për elementet e rishfrytëzueshme	Elementet e rishfrytëzueshme të shitur	Elementet e papërdorura për riciklim	Metoda e trajtimit	Gjenealitet e personit marrës të autorizuar			Data e dorëzimit
		Emri Mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma								Emri Mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma	

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

**MODELI I REGJISTRIT PËR VEPRIMTARITË E RIPARIMIT DHE TE MIRËMBAJTJES SE Pjesëve mekanike dhe te motorit**

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për ndërhyrjen e kryer	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Data e dorëzimit
		Emri Mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma					Emri Mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma	

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.



**MODELI I RREGJISTRIT PER VEPRIMTARITE E RIPARIMIT DHE TE MIREMBAJTJES SE GOMAVE**

Nr.	Data e hyrjes	Gjenealitet e personit dorezues te autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targes	Numri i shasise	Te dhena per nderhyrjen e kryer	Gjenealitet e personit marres te autorizuar			Data e dorezimit
		Emri Mbiemri	Nr. I identifikimit	Firma					Emri Mbiemri	Nr. I identifikimit	Firma	

Shënim: Rregjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.





**MODELI I REGJISTRIT PËR NDËRMJETËSIMIN NË SHITBLERJEN E MJETEVE**

Nr.	Data e hyrjes	Gjenealitet e furnitorit			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për origjinën dhe dokumentet e qarkullimit	Gjenealitet e blerësit të autorizuar			Data e shitjes ose heqjes
		Emri Mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma					Emri Mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma	

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime. Të dhënat për origjinën e mjeteve dhe/ose rimorkjove shënohen në çastin e marrjes në ngarkim. Të dhënat për shitjen ose heqjen shënohen në çastin e shitjes ose heqjes së tyre.

**MODELI I RREGJISTRIT PER NDËRMJETËSIMIN NË SHITBLERJEN E MJETEVE**

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e furnitorit			Tipi i mjetit	Numri i targes	Numri i shasise	Te dhena per origjinen dhe dokumentat e qarkullimit	Gjeneralitet e blerësit të autorizuar			Data e shitjes ose heqjes
		Emri Mbiemri	Nr. I identifikimit	Firma					Emri Mbiemri	Nr. I identifikimit	Firma	

Shënim: Rregjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime. Të dhënat për origjinën e mjeteve dhe/ose rimorkjove shënohen në çastin e marrjes në ngarkim. Të dhënat për shitjen ose heqjen shënohen në çastin e shitjes ose heqjes së tyre.

**MODELI I RREGJISTRIT PER SHITBLERJET E PJESËVE TË KËMBIMIT TË MJETEVE**

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e furnitorit			Pjesa e këmbimit	Te dhena per origjinen	Te dhena te tjera	Gjeneralitet e blerësit te autorizuar			Data e shitjes ose heqjes
		Emri Mbiemri	Nr. I identifikimit	Firma				Emri Mbiemri	Nr. I identifikimit	Firma	

Shënim: Rregjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

**UDHËZIM**  
**Nr.9, datë 3.7.2007**

**PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHITBLERJES, NDËRMJETËSIMIT, TË  
AUTORIPARIMIT, PËR MJETET RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOT E TYRE,  
TË AUTORIZUARA NGA PRODHUESI**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”,

**UDHËZOJ:**

**Neni 1**

1. Subjektet juridike, për të ushtruar veprimtarinë e shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuara nga prodhuesi, duhet të disponojnë:

I. Pajisjet:

- Gropë riparimi ose pajisje ngritëse (mekanike, hidraulike ose elektrike), sipas standardeve teknike;

- Elektrokompresor;

- Pajisje për kontrollin e parametrave elektrikë, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit;

- Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergjençës së gomave;

- Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave;

- Pajisje për çmontimin dhe montimin e gomave;

- Kompjutera;

- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;

- Kutinë e ndihmës së shpejtë.

II. Instrumentet:

- Llamba portative me transformator 220/24 – 36 volt;

- Diagnostikues për kontrollin e parametrave të punës së motorit;

- Vegla matëse e të kontrollit, për profesionet motorist, xhenerik, elektroauto etj.;

- Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave;

- Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave etj.

III. Ambientet:

- Tetoja me sipërfaqe të mbyllura, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrit;

- Vend qëndrimi për mjetet që do të shiten;

- Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen;

- Zyrë për punë administrative;

- Nyje hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me leje për të ushtruar veprimtarinë e shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuara nga prodhuesi, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

- Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me leje për të ushtruar veprimtarinë e shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuara nga prodhuesi, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;

- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

sipas formatit të hartuar nga Drejtoria e Licencimit dhe formularit tip të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (bashkëlidhur). Gjithashtu kërkesa shoqërohet me:

- kopje të noterizuara të vendimit të regjistrimit në gjykatë;

- kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

- kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

- vetëdeklarim të përgjegjësit teknik, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të merret leja nga subjekti, për gjendjen e tij në lidhje me punësimin si përgjegjës teknik në shoqëri të tjera dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin;

- kontratë me prodhuesin, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit, për shitblerjen, ndërmjetësimin, autoriparimin, e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.

3. DPSHTRR-ja, përpara dhënies së lejes nga Ministria, për veprimtarinë që kërkohet të ushtrohet nga subjekti, në vijim të kërkesës së subjektit, me komision, verifikon plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, dhe kur plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara, lëshon një vërtetim për subjektin. Vërtetimi dorëzohet në Ministri nga subjekti, së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

## Neni 2

Tarifat e licencimit janë:

- Për leje njëvjeçare, për subjektet juridike, për të ushtruar veprimtarinë e shitblerjes, ndërmjetësimin, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuar nga prodhuesi, është 20 000 (njëzet mijë) lekë.

- Për leje mbi një vit, kur kërkohet nga subjekti, është e barabartë me vleftën, që del nga shumëzimi i tarifës njëvjeçare (20 000 lekë) me numrin e viteve që kërkohet leja.

## Neni 3

Përpara marrjes së lejes së veprimtarisë, subjektet duhet të ngurtësojnë dhe të dorëzojnë në Ministri vlerën e garancisë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

## Neni 4

1. Përgjegjësi teknik, për të marrë dëshminë e aftësisë profesionale, duhet të ketë njohuritë e domosdoshme mbi:

- ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- udhëzimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së shitblerjes, ndërmjetësimin, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuar nga prodhuesi”, e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- përgatitjen tekniko-profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, karrocërisë, pjesëve elektrike, gomave, blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, dhe të pjesëve të ndërrimit të tyre;

- rregullat e sigurimit teknik në punë;

- rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

2. DPSHTRR-ja organizon kurse kualifikimi, sipas programeve të miratuara nga Ministria, për ngritjen e nivelit tekniko-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrojnë veprimtarinë e shitblerjes, ndërmjetësimin, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuar nga prodhuesi.

3. Përgjegjësi teknik, për t’u pajisur me “Dëshmi aftësie profesionale”, duhet të paraqesë në

#### DPSHTRR:

- kërkesë për pajisje me "Dëshmi aftësie profesionale", ku të përcaktohet veprimtaria e shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuar nga prodhuesi, si dhe veprimtaria e tij që ka kryer, nga marrja e diplomës, në formën e CV-së;

- kopje të noterizuara të diplomës;
- certifikatë personale me fotografi;

- dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuara) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre etj.;

- vetëdeklarim i personit, në lidhje me gjendjen e tij me organin e gjykatës, që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006;

- vërtetim nga organi shëndetësor përkatës, brenda juridiksionit ku banon, për aftësitë fizike, për të kryer veprimtarinë e shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre.

4. Përgjegjësi teknik pajiset me "Dëshmi aftësie profesionale" nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi të ketë kaluar provimin për nivelin e njohurive, për veprimtarinë e shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuar nga prodhuesi, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 5

1. Modelet e regjistrave janë bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Plotësimi i regjistrave duhet të bëhet i plotë, me saktësi dhe në mënyrë të rregullt kronologjike.
3. Ruajtja e regjistrave në arkivë duhet të bëhet sipas rregullave të arkivave.

#### Neni 6

1. Të gjitha subjektet që pajisen me leje veprimtarie sipas këtij udhëzimi, para fillimit të aktivitetit të përcaktuar në lejen e veprimtarisë:

- duhet të bëjnë ndryshimet në vendimin e gjykatës, për veprimtarinë e licencuar;
- duhet të bëjnë ndryshimet në organin tatimor, për veprimtarinë e licencuar;
- duhet të dorëzojnë në Ministri dokumentet e ndryshuara, të gjykatës dhe të organit tatimor.

2. Ministria nuk do të bëjë rinovimin e lejes së veprimtarisë, në rast se nga subjekti nuk është bërë depozitimi i ndryshimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 7

1. MPPTT-ja, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, u lëshon lejet për veprimtarinë që kërkohet, subjekteve që plotësojnë të gjitha kërkesat e këtij udhëzimi.

2. MPPTT-ja, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, u kthen përgjigje subjekteve që nuk plotësojnë të gjitha kërkesat e këtij udhëzimi.

3. Në rastet kur MPPTT-ja nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, leja e kërkuar nga subjektet konsiderohet e miratuar dhe subjektit i lind drejta të fillojë veprimtarinë.

#### Neni 8

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT  
DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
**Sokol Olldashi**

Datë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**FORMULARI TIP I AUTODEKLARIMIT**

**AUTODEKLARIM**

**Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore  
Drejtoria e Licencimit  
T i r a n ë**

**Pjesa e parë** (do të përmbajë gjeneralitetet e përgjithshme)

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, deklaroj që jam banues në adresë \_\_\_\_\_, me seli \_\_\_\_\_, tel.: \_\_\_\_\_, cel.: \_\_\_\_\_ dhe me dokument identifikimi/nr. i pasaportës \_\_\_\_\_.

Deklaroj që jam regjistruar në organet tatimore me nr. NIPT-i \_\_\_\_\_, me vendim gjykatë nr. \_\_\_\_\_, nuk jam në pocës falimentimi, nuk jam në pocës hetimi dhe as në pocës gjyqësor. Nuk kam asnjë detyrim financiar (ndaj të tretëve) Drejtoria e Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve (**për subjektet juridike**).

**Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.**

**Pjesa e dytë** (informacion i përgjithshëm lidhur me aktivitetin që ka kryer më parë subjekti, me pyetje alternative)

1. Keni licencë të mëparshme PO / JO  
Nëse po, specifikoni fushën \_\_\_\_\_

2.

**Pjesa e tretë** (përgjegjësia e vetë subjektit në rast se ai nuk ka zbatuar apo ka dhënë informacion jo të saktë, atëherë do të përballet me ligjin në fuqi për raportim jo të saktë të të dhënave)

**Deklaroj**

Që të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE**  
**TELEKOMUNIKACIONIT**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE**  
**DREJTORIA E LICENCIMIT**

**L E J E**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_

**PËR**

**USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHITBLERJES, NDËRMJETËSIMIT, TË**  
**AUTORIPARIMIT PËR MJETET RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOT E TYRE,**  
**TË AUTORIZUARA NGA PRODHUESI \_\_\_\_\_**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, lëshon këtë leje.

**I LËSHOHET:**

- **Subjektit juridik:** \_\_\_\_\_
- **Administrator:** \_\_\_\_\_
- **Me seli në:** \_\_\_\_\_

**Leja është e vlefshme deri në datën \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_ .**

\_\_\_\_\_  
( Emri, mbiemri )  
M I N I S T Ë R









**UDHËZIM**  
**Nr.10, datë 3.7.2007**

**PËR KRITERET E LICENCIMIT TË AGJENCIVE, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRAJTIMIT TË PRAKTIKAVE TË QARKULLIMIT TË MJETEVE ME MOTOR DHE/OSE TË RIMORKIOVE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparin, shitblerjen, depozitim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”,

**UDHËZOJ:**

**Neni 1**

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, duhet të disponojnë:

- zyrë për punë administrative;
- nyje hidrosanitare;
- kompjutera.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me leje për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

- Kërkesë e drejtuesit ligjor për pajisjen me leje për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, ku të përcaktohen emri i subjektit, drejtuesit ligjor, që përmban dhe vetëdeklarimin për:

- a) gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- b) njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- c) dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;
- d) informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

sipas formatit të hartuar nga Drejtoria e Licencimit dhe formularit tip të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (bashkëlidhur). Gjithashtu kërkesa shoqërohet me:

- kopje të noterizuara të vendimit të regjistrimit në gjykatë;
- kopje të vërtetimit të aftësisë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë;
- vërtetim nga DRSHTRR-ja, për plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

**Neni 2**

1. Tarifa për leje njëvjeçare, për subjektet juridike, për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove është 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

2. Tarifa për leje mbi një vit, kur kërkohet nga subjekti, është e barabartë me vleftën, që del nga shumëzimi i tarifës njëvjeçare (10 000 lekë) me numrin e viteve që kërkohet leja.

**Neni 3**

Përpara marrjes së lejes së veprimtarisë, subjektet duhet të ngurtësojnë dhe të dorëzojnë në Ministri, vlerën e garancisë prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh.

#### Neni 4

1. Titullari i agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, për të marrë vërtetimin e aftësisë profesionale për agjencitë, duhet të ketë njohuritë e domosdoshme mbi:

- ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”;

- vendimin e Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 252;

- udhëzimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove” e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- udhëzimin “Për regjistrimin e mjeteve rrugore” e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. DPSHTRR-ja organizon kurse kualifikimi, sipas programeve të miratuara nga MPPTT-ja, për ngritjen e nivelit tekniko-profesionale të titullarëve dhe të punonjësve të tjerë, të agjencive për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove.

3. Titullari i agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, për të marrë vërtetimin e aftësisë profesionale për agjencitë, duhet të paraqesë në DRSHTRR:

- kërkesë për pajisje me “Vërtetim të aftësisë profesionale për agjenci”, ku të përcaktohen, ku do të aplikojë dhe veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës, në formën e CV-së;

- kopje të noterizuara të diplomës;

- certifikatë personale me fotografi;

- dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuara) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së agjencisë etj.

4. Titullari i agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, pajiset me “Vërtetimin e aftësisë profesionale për agjencitë” nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi të ketë kaluar provimin për nivelin e njohurive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 5

1. Modelet e regjistrave janë bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Plotësimi i regjistrave duhet të bëhet i plotë, me saktësi dhe në mënyrë të rregullt kronologjike.

3. Ruajtja e regjistrave ne arkivë duhet të bëhet sipas rregullave të arkivave.

#### Neni 6

1. Të gjithë subjektet që pajisen me lejen e veprimtarisë së agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, përpara fillimit të aktivitetit të përcaktuar në lejen e veprimtarisë:

- duhet të bëjnë ndryshimet në vendimin e gjykatës, për veprimtarinë e licencuar;

- duhet të bëjnë ndryshimet në organin tatimor, për veprimtarinë e licencuar;

- duhet të dorëzojnë në Ministri, dokumentet e ndryshuara të gjykatës dhe të organit tatimor.

2. Ministria nuk do të bëjë rinovimin e lejes së veprimtarisë, në rast se nuk është bërë depozitimi i ndryshimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 7

1. Numri i agjencive për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, është bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara në çdo qytet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

#### Neni 8

1. MPPTT, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, u lëshon lejet për veprimtarinë që kërkohet, subjekteve që plotësojnë të gjitha kërkesat e këtij udhëzimi.

2. MPPTT, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, u kthen përgjigje subjekteve që nuk plotësojnë të gjitha kërkesat e lartpërmendura në këtë nen.

3. Në rastet kur MPPTT-ja nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, leja e kërkuar nga subjektet konsiderohet e miratuar dhe subjektit i lind e drejta të fillojë veprimtarinë.

#### Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT  
DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
**Sokol Olldashi**

NUMRI I AGJENCIVE, BAZUAR NË NUMRIN E MJETEVE TË REGJISTRUARA

Nr.	Qendra administrative	Numri i agjencive	VËREJTJE
1.	Berat	40	
2.	Kuçovë	20	
3.	Skrapar	20	
4.	Durrës	120	
5.	Krujë	20	
6.	Kavajë	30	
7.	Gjirokastrë	30	
8.	Tepelenë	20	
9.	Përmet	20	
10.	Sarandë	20	
11.	Delvinë	20	
12.	Laç	20	
13.	Lezhë	20	
14.	Mirditë	20	
15.	Elbasan	60	
16.	Peqin	20	
17.	Gramsh	20	
18.	Librazhd	20	
19.	Korçë	50	
20.	Ersekë	20	
21.	Pogradec	20	
22.	Devoll	20	
23.	Shkodër	80	
24.	Malësi e Madhe	20	
25.	Pukë	20	
26.	Dibër	20	
27.	Bulqizë	20	
28.	Mat	20	
29.	Fier	70	
30.	Mallakastër	20	
31.	Lushnje	30	
32.	Kukës	20	
33.	Bajram Curri	20	
34.	Has	20	
35.	Vlorë	70	
36.	Tiranë	300	
	TOTALI	1380	

Datë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

## FORMULARI TIP I AUTODEKLARIMIT

### AUTODEKLARIM

Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore  
Drejtorisë se Licencimit

T i r a n ë

#### Pjesa e parë (do të përmbajë gjeneralitetet e përgjithshme)

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, deklaroj që jam banues në adresë \_\_\_\_\_, me seli \_\_\_\_\_, tel.: \_\_\_\_\_, cel.: \_\_\_\_\_ dhe me dokument identifikimi / nr. i pasaportës \_\_\_\_\_.

Deklaroj që jam regjistruar në organet tatimore me nr.NIPT-i \_\_\_\_\_, me vendim gjykate nr. \_\_\_\_\_, nuk jam në poces falimentimi, nuk jam në poces hetimi dhe as në poces gjyqësor. Nuk kam asnjë detyrim financiar (ndaj të tretëve) Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve (për subjektet juridike).

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

**Pjesa e dytë** (informacion i përgjithshëm lidhur me aktivitetin që ka kryer më parë subjekti, me pyetje alternative)

1. Keni licencë të mëparshme PO / JO  
Nëse po, specifikoni fushën \_\_\_\_\_

2.

**Pjesa e tretë** (përgjegjësia e vetë subjektit në rast se ai nuk ka zbatuar apo ka dhënë informacion jo të saktë, atëherë do të përballlet me ligjin në fuqi për raportim jo të saktë të të dhënave)

#### Deklaroj

Që të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE  
TELEKOMUNIKACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE  
DREJTORIA E LICENCIMIT**

**L E J E**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_

**PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCIVE QË TRAJTOJNË  
PRAKTIKAT E QARKULLIMIT RRUGOR**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 29 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit lëshon këtë leje.

**I LËSHOHET:**

**Subjektit juridik:** \_\_\_\_\_

**Administrator:** \_\_\_\_\_

**Me seli në:** \_\_\_\_\_

**Leja është e vlefshme deri në datën \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_.**

\_\_\_\_\_  
( Emri, mbiemri )  
**MINISTËR**



**URDHËR**  
**Nr.4211, datë 7.6.2007**

**MBI MASAT PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË QARKULLIMIT TË MJETEVE  
TË TRANSPORTIT TË MALLRAVE, GJATË SEZONIT TURISTIK**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 6 të ligjit nr.8378 datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Brendshëm

**URDHËROJNË:**

Në kuadrin e masave për sezonin turistik veror 2007 dhe në zbatim të detyrave të dala nga urdhri nr.68, datë 24.4.2007 i Kryeministrit "Për përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të masave për sezonin turistik veror 2007" të merren këto masa:

1. Me qëllim të lehtësimit të trafikut në disa akse rrugore të cilat kalojnë në zonat turistike, të pezullohet përkohësisht qarkullimi i mjeteve të transportit të mallrave, që kanë peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 ton, përjashtuar mjetet frigoriferike që kanë peshë maksimale me ngarkesë deri në 5 ton.

2. Pezullimi i qarkullimit të bëhet në segmentet rrugore kombëtare, si:

i) Shkodër – Velipojë;

ii) Shkodër – Lezhë – Milot – Fushë Krujë – Vorë – Durrës;

iii) Durrës – Rrogozhinë – Lushnjë – Fier – Vlorë;

iv) Vlorë – Himarë – Sarandë – Butrint.

3. Pezullimi i qarkullimit do të bëhet vetëm për periudhën nga 15 korriku, deri më 31 gusht 2007, prej orës 8<sup>00</sup> deri në orën 22<sup>00</sup>.

4. Transporti i mallrave me mjete, që kanë peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 ton, gjatë kësaj periudhe, do të bëhet nga ora 22<sup>00</sup> deri në orën 8<sup>00</sup>.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të marrë masa të menjëhershme për vendosjen e sinjalizimit rrugor të nevojshëm.

6. Në zbatim të pikës 5 të nenit 6 të Kodit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, kryetari i këshillit të qarkut dhe kryetari i komunës ose bashkisë, shpallin urdhëresa për zbatimin e këtij urdhri, për rrugët nën juridiksionin e tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prefektët, drejtoritë e policisë në qarqe, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

8. Për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit për Transportin dhe Telekomunikacionin në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Prefekturave në Ministrinë e Brendshme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT  
DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
Sokol Olldashi**

**MINISTRI I BRENDSHËM  
Bujar Nishani**

## **SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i shkarjeve në Patos Fshat dhe Fratar.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët, që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Të gjithë pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, “Proces regjistrimi”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8564, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 655 596 (tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 Qarku : Fier  
 Komuna : Patos  
 Fshati : Patos - Fshat

Lista e Pronareve qe preken nga rehabilitimi i rreshqitjeve ne, ( Patos - Fshat ).  
 Lloji i pasurise : Toke are dhe dru - frutor, nr .( 1-17 ).

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. i pas.	Toke bujq.			Totali	Shenime
					Siperfaqja m <sup>2</sup>	Cimimi lek/m <sup>2</sup>	Vlera /leke		
1	Fadil	Isuf	Resuli	6/18	650	300	195000	195000	Plotësim dokumentacioni
2	Flamur	Kadri	Resuli	6/17	364	300	109200	109200	Plotësim dokumentacioni
3	Pellumb	Kadri	Resuli	6/16	208	300	62400	62400	Plotësim dokumentacioni
4	Faik	Kadri	Resuli	6/15	156	300	46800	46800	Plotësim dokumentacioni
5	Kadri	Hasan	Resuli	6/14	351	300	105300	105300	Plotësim dokumentacioni
6	Pajtim	Rrapo	Malaj	6/10	850	300	255000	255000	Plotësim dokumentacioni
7	Hysni	Hekuran	Merkaj	6/8	540	300	162000	162000	Plotësim dokumentacioni
8	Nuri	Como	Kalemi	6/7	429	300	128700	128700	Plotësim dokumentacioni
9	Sefret	Nexhip	Kalemi	6/6	338	300	101400	101400	Plotësim dokumentacioni
10	Enver	Sefret	Beqiri	6/5	338	300	101400	101400	Plotësim dokumentacioni
11	Hasan	Sefret	Beqiri	6/4	481	300	144300	144300	Plotësim dokumentacioni
12	Bajram	Sefret	Beqiri	6/3	700	300	210000	210000	Plotësim dokumentacioni
13	Haki	Gjysho	Beqiri	6/2	420	300	126000	126000	Plotësim dokumentacioni
14	Luftar	Gjysho	Beqiri	6/1	2380	300	714000	714000	Plotësim dokumentacioni
15	Astrit	Como	Kamberi	5/50	640	300	192000	192000	Plotësim dokumentacioni
	<b>Shuma</b>				<b>8845</b>		<b>2653500</b>	<b>2653500</b>	

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**Qarku : Fier**

**Komuna : Patos**

**Fshati : Fratar**

Lista e Pronareve qe preken nga rehabilitimi i rreshqitjeve ne, (Fratar ).  
Lloji i pasurise : Toke are nr ( 1-4 ).

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Toke bujq.				Truall			Totali	Shenime
				Nr. i pas.	Siperfaqja m <sup>2</sup>	Vlera cmimi lek / m <sup>2</sup>	Vlera leke	Sip. Truall	Cmimi /m <sup>2</sup>	Vlera Leka		
1	Shyqyni	Ramadan	Ymeraj	tapi	780	982	765960				765960	Proces regjistrimi
2	Asllan	Jahja	Islami	tapi	28	982	27496				27496	Proces regjistrimi
3	Ramadan	Fehim	Mustafaj	tapi	20	982	19640				19640	Proces regjistrimi
4	Brahim	Musa	Filaj	555/1				189	1000	189000	189000	Plotësim dokumentacioni
	<b>Shuma</b>				<b>828</b>		<b>813096</b>				<b>1002096</b>	

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468  
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) .....	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

### Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 10.7.2007  
Doli nga shtypi më 11.7.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"  
Tiranë, 2007

Çmimi 48 lekë